

Procesi i demobilizimit dhe integritit të ish pjesëtarëve të ushtrisë çlirimtare – perspektiva e Kosovës¹

Hyrje

Çështja e çarmatimit, demobilizimit dhe ri-integritit (DDR) të formacionit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) ka kaluar nëpër cikle të ndryshme. Në fakt, pas përfundimit të konfliktit në Kosovë dhe hyrjes së forcave të NATO-s, njëra ndër sfidat kryesore në vend i referohej çështjes së demobilizimit të tërësishëm të Kosovës. Përfundimi i konfliktit në vend u vulos me nënshkrimin e Marrëveshjes së Kumanovës² ndërmjet NATO-s dhe Ushtrisë Jugosllave e cila u morr për bazë në mbledhjen e Këshillit të Sigurimit që miratoi Rezolutën 1244 për Kosovën. Kjo rezolutë në mënyrë eksplicite parasheh demobilizimin dhe rindërtimin e Kosovës.³

Për më shumë, demobilizimi i UÇK-së ishte përmendur në një dokument që quhej “Marrëveshja për demilitarizimin dhe transformimin e UÇK-së” e nënshkruar nga NATOi dhe UÇK me datë 20.06.1999 menjëherë pas përfundimit të luftës në Kosovë dhe hyrjes së trupave të NATO-s në Kosovë. Ky dokument merr në konsideratë kontributin e UÇK-së si dhe parasheh që në të ardhmen Kosova do të ketë një formacion ushtarak duke u bazuar në modelin e Gardës Nacionale të SHBA-ve.⁴ pas përfundimit të procesit politik për determinizmin e statusit të Kosovës. Në fakt modeli i Gardës Nacionale të SHBA-ve asnjëherë nuk u aplikua mirëpo një marrëveshje e mëvonshme i hapi rrugë transformimit të UÇK-së në një forcë civile të uniformuar për reagim emergjent të quajtur Trupat Mbrojtëse të Kosovës (TMK).

Ndjeshmëria e problematikës së demobilizimit të UÇK-së nuk i morri për bazë aspektet e integritit të minoriteteve në forcën e re. Për më shumë, aspekti gjinor në fazën e menjëhershme të pasluftës ishte deri dikund i pranueshëm por larg nga niveli i dëshirueshëm. Duke e pasur parasysh pozicionin unik të Kosovës dhe procesin e veçantë të demokratizimit, Kosova nuk kaloi nëpër fazat e Reformës së Sektorit të Sigurisë (RSS) mirëpo procesi iu atribua Zhvillimit të

¹ Ky punim është shkruar nga z. Ramadan Qehaja, Drejtor në QKSS, z. Kosum Kosumi Përgjegjës për Hulumtime në QKSS dhe Florian Qehaja Udhëheqës i Operativës në QKSS. Dy autorët e parë kanë qenë pjesëmarrës të drejtpërdrejtë në procesin e konsolidimit të TMK-së.

² Për më shumë detaje për Marrëveshjen e Kumanovës shih

<http://www.nato.int/kosovo/docu/a990609a.htm>

³ Këshilli i Sigurimit i KB-ve, Rezoluta 1244 (1999)

⁴ KFOR, Marrëveshja për demilitarizimin e UÇK-së, (1999)

Sektorit të Sigurisë (ZHSS).⁵ Kjo për faktin se ndërtimi i të gjitha institucioneve të sigurisë në vend filloi nga zeroja dhe nuk kishte një korrelacion institucional me sistemin e mëhershëm socialist në ish-Jugosllavi.

Ky vlerësim synon që shkurtimisht të analizojë kontekstin e demobilizimit dhe ri-integrimit të pjesëtarëve të ish UÇK-së që nga viti 1999. Është përdorur qasja holistike duke filluar që nga periudha e pas-luftës deri në ditët e sotme. Për formësimin e këtij vlerësimi janë referuar dokumente të ndryshme të institucioneve dhe artikuj akademik. Për më shumë ky vlerësim reflekton edhe përvojën personale të dy bashkë-hartuesve të këtij punimi.

Pjesa e parë elaboron demobilizimin dhe ri-integrimin e pjesëtarëve të UÇK-së në TMK, institucione tjera të sigurisë dhe në jetën civile. Më vonë, ky dokument i kushton rëndësi procesit të konsolidimit të TMK-së. Procesi i ZHSS do të elaborohet në pjesën që ka të bëjë me zhvillimet e pas-pavarësisë në Kosovë dhe së fundi konkluzionet.

Demobilizimi dhe ri-integrimi i pjesëtarëve të UÇK-së

Procesi i demobilizimit në Kosovë ishte i vështirë dhe kompleks. Trashëgimia e luftërave në ish-Jugosllavi e bëri shumë të vështirë demobilizimin e pjesëtarëve të formacioneve të UÇK-së ngase realiteti i tillë ishte vështirë i pranueshëm. Nevoja e madhe për vendosjen e paqes dhe rendit në Kosovë e shtyri bashkësinë ndërkombëtare që të jetë më këmbëngulëse në realizimin e këtij procesi i cili rrjedh nga dokumentet ligjore si më poshtë:

- Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të KB-ve, 10 Qershor 1999
- Marrëveshja për Çmilitarizim dhe Transformim, 21 Qershor 1999
- Rregullorja e UNMIK-ut 1999/8, 20 shtator 1999
- Deklarata e Parimeve e Komandantit të KFOR-it, 20 shtator 1999.
- Korniza Kushtetuese e Kosovës

Mirëpo, implementimi në praktikë i këtyre marrëveshjeve hasi në vështirësi si për nga aspekti i mundësive që ekzitonin për integrim në forcat ardhshme ashtu edhe për gjendjen e rëndë socio ekonomike e që reflektoi mundësi të limituara për integrimin e tyre në jetën civile. Organizata Ndërkombëtare për Migrimim (IOM) morri besimin e bashkësisë ndërkombëtare për të marrë përsipër këtë proces dhe u angazhua në veçanti në programin e ri-sistemimit të këtyre

⁵ KCSS, Context Analyzes of SSR in Kosovo, p.5

pjestarëve. Ky program ishte vlerësuar si shumë i suksesshëm në regjistrimin, demobilizimin dhe ri-integrimin e 10.000 luftëtarëve të UÇK-së si në TMK por edhe programet tjera të ofruara në jetën civile.⁶ Një pjesë e ish-pjesëtarëve u integrua në strukturën policore e cila u formua menjëherë pas luftës.⁷ Në përgjithësi, qëllimi i pjesës dërrmuese të këtyre pjesëtarëve ishte vazhdimësia në institucionet e sigurisë dhe më pak ishin ata të interesuar që të i ktheheshin jetës civile.

Në anën tjetër, përfshirja e tyre në jetën sociale ishte bërë deri në një masë duke u dhënë atyre mbështetje financiare dhe ofrim të trajnimeve për kyçje e tyre në sektorë të ndryshëm ekonomik e social në vend. Kjo u cilësua si shumë e domosdoshme për faktin se numri i kufizuar në forcën e ardhshme - TMK⁸ dhe në polici nuk mund të absorbonte të gjitha kërkesat e ish-pjesëtarëve.

Në fazën e menjëhershme të pasluftës, kriteret për inkuadrimin e pjesëtarëve minoritarë nuk janë respektuar dhe si të tillë nuk janë marrë për bazë. Kërkesat e mëdha nga komuniteti shumicë për punësim në strukturat e reja të sigurisë pamundësuan adresimin e integritit të minoriteteve. Po ashtu, ekzistonte problemi i përfshirjes gjinore në institucionet e sigurisë edhe pse në krahasim me minoritetet, përqindja e përfaqësimit të tyre ishte solide. Përderisa në formësimin e TMK-së pjesëmarrja e minoriteteve dhe gruas ishte më e vështirë, kriteret e vendosura në përzgjedhjen e pjesëtarëve të policisë kërkonin domosdoshmërisht përfaqësimin e këtyre shtresave.

Transformimi i UÇK-së dhe konsolidimi i Trupave të Mbrojtjes së Kosovës (TMK)

TMK ishte trashigimtare e drejtëpërdrejtë e formacionit të luftës – UÇK-së. TMK-ja është formuar nga UNMIK-u me Rregulloren 8/1999 dhe nën autoritetin e Përfaqësuesit Special të OKB-së, me detyra dhe mision krejtësisht civil e ndërtuar në bazë të modelit francez të *Security Civile*. Mirëpo vendorët e shihnin këtë organizatë si ushtarake apo paraardhësen e ushtrisë së Kosovës pavarësisht që ishte fuqi e rezervuar dhe plotësisht operationale vetëm nën autoritetin e misionit të OKB-së. Edhe pse kërkohet një studim i veçantë ia vlen të përmendet që kompetencat e rezervuara të misionit të KB-së pamundësuan pronësinë lokale

⁶ IOM, Kosovo KPC, 2000

Deri në 20.000 persona kanë aplikuar për pozita në TMK. Prej tyre 17.000 kanë qenë luftëtarë të UÇK-së prej 27.000 sa kanë qenë të evidentuar gjithsej.

⁷ Për më shumë informata për Policinë e Kosovës dhe historikun shih <http://www.kosovopolice.com>

⁸ Jo më shumë se 5000 pjestarë

në procesin e demobilizimit duke imponuar praktika të jashtme të RSS.⁹ Kjo situatë u vërtetua të ishte si pavolitshme.

Krahas regjistrimit dhe integritit të ish-pjestarëve të UÇK-së, IOM-it prapë iu besuan detyrat për të zhvilluar kapacitete për të ardhmen e TMK-së me detyra të mbrojtjes civile. Trajnimet ishin dizajnuar që të promovojnë përgjegjshmëri personale, disiplinë, aftësi bazike individuale, aftësi organizative dhe trajnime të specializuara për mbrojtje civile. Përveç këtyre trajnimeve, programi i IOM-it ishte të siguroj dhe aftësoj pjesëtarët e TMK-së me eksperiencat e tyre praktike për aktivitete trajnuese përmes projekteve civile dhe humanitare.

Vlen të theksohet se në aspektin strukturor, organogrami i TMK-së nuk dallonte nga ai i ish-UÇK-së. Shumica e stafit komandues ishin ish luftëtarë të UÇK-së dhe tani kishin pozita të reja edhe në TMK. P.sh nga gjashtë Zona Mbrojtëse të TMK-së në pesë prej tyre komandant ishin pikërisht nga zonat nga edhe ishin gjeografikisht, gjë e cila edhe nuk është treguar shumë efikase në funksionimin dhe zbatimin e përgjegjësive që kishin në nivelin e lidërshiptit. Kur të merren parasysh të gjitha këto rrethana del se TMK ishte një organizatë e vogël e uniformuar me strukturë të rangjeve të larta të panevojshme. Raportet e ndryshme adresonin dobësi duke i pasur parasysh nepotizmin dhe lidhshmërinë në mes të pjesëtarëve gjë që e cila ka vështirësuar shpesh funksionimin me sukses të linjës komanduese lartë-poshtë.¹⁰

Në anën tjetër, konsolidimi i TMK-së u dëshmuar me plotësimin e standardit ndërkombëtar të përcaktuar nga bashkësia ndërkombëtare i njohur ndryshe edhe si Standardi i VIII-të.¹¹ Ky standard ngërthente në vete kritere për tu përmbushur e që kryesisht kishin të bënin me përmbushjen e mandatit të TMK-së e në veçanti, përfaqësimin e minoriteteve.¹² Kjo bëri që procesi i ZHSS të merr kahje më gjithëpërfshirëse duke i kushtuar rëndësi të veçantë integritit të minoriteteve dhe barazisë gjinore. Përmbushja e këtyre kritereve ishte vlerësuar nga opinioni i brendshëm dhe ndërkombëtar e që rezultoi në një përbërje si më poshtë:¹³

- Pozita të caktuara: 5052
- Pjesëtarë aktiv: 3052

⁹ KCSS, Context Analyzes of Security Sector Reform in Kosovo, f.12

¹⁰ ISSR, f.102

¹¹ UNMIK, Standards for Kosovo, p.15

¹² Ibid, p.16

¹³ Të dhëna të vitit 2006

- Pjesëtarë rezervë: 2000
- Numri zyrtarëve civil: 100
- Pakicat e përbëjnë: 10%
- Pjestare të gjinis femerore: 3.2%
- Profili: Shumëkombëshe, jofetare, jopolitike

Përfaqësimi i minoriteteve në TMK kërkonte inkuadrimimin e tyre edhe në pozita kyçe komanduese. Mirëpo pozicioni politik në të cilën gjendej Kosova si dhe refuzimet e minoritetit serb për të qenë pjesë e kësaj strukture vështirësoi pozicionimin e këtyre pjestarëve në nivele të larta komanduese. Në anën tjetër, pjesëmarrja e gruas në pozita të larta sa erdhi e shtohet duke u punësuar në nivele të udhëheqësve të departamenteve dhe sektoreve në TMK.

Një ndër sfidat e mëdha ishte mbikëqyrja demokratike e TMK-së për faktin se korniza ligjore nuk parashihet një gjë të tillë dhe se kompetencat e rezervuara të misionit të KB-së pamundësuan sidomos atë që quhet kontrolli horizontal mbi mekanizmat e sigurisë.¹⁴ Roli i parlamentit ishte i limituar¹⁵ dhe ajo pak mbikëqyrje zhvillohej nëpërmjet Komisionit Parlamentar për Gatishmëri Emergjente. Kjo gjendje shkaktoi vështirësi në fuqizimin e mbikëqyrjes demokratike në periudhën që pasoi.

Periudha e pas-pavarësisë – shpërbërja e TMK-së dhe themelimi i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK)

Shpallja e pavarësisë së Kosovës me 17 Shkurt 2008 koicidoi me një propozim për një arkitekturë të re të sigurisë në Kosovë e bazuar në Planin e të dërguarit të KB për Statusin e Kosovës i njohur si Plani i Ahtisaarit.¹⁶ Kjo arkitekturë kishte efekt të dyfishtë: kishte për qëllim konsolidimin dhe zhvillimin e FSK-së dhe Agjencisë Intelgjente në vend e që rrjedhimisht konsiston me ZHSS një njërën anë, si dhe reformimin e policisë dhe emergjencave civile e që përkon me RSS, në anën tjetër.¹⁷

Kjo strukturë e sektorit të sigurisë përjashtonte vazhdimësinë që dilte nga lufta e që ishte konsoliduar në TMK. Propozimi i KB ishte që TMK të shpërbëhej me dinjitet dhe t'i hapet rrugë formimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës. Kjo nënkuptonte që zhvillimi i institucionit të FSK-së nuk do të ketë korrelacion

¹⁴ DCAF, Democratic Control of Armed Forces, f.1

¹⁵ KCSS, Context Analyzes of Security Sector Reform in Kosovo, f.9

¹⁶ Për më shumë info për këtë plan shih <http://www.unosek.org/unosek/en/statusproposal.html>

¹⁷ KCSS, Context Analyzes of Security Sector Reform in Kosovo

institucional me TMK-në mirëpo forca e re do të krijohet që nga fillimi.¹⁸ Edhe pse nuk kishte ndërlidhje në mes të këtyre dy mekanizmave, ishte evidentuar që së paku 50 % e forcës prej 2.500 aktiv dhe 800 rezervë të FSK-së do të jenë ish pjesëtarë të TMK-së¹⁹ e shumica prej tyre ish-pjesëtarë të formacioneve të UÇK-së.

Shpërbërja e trashëgimtares së drejtpërdrejt të UÇK-së u përcoll me reagime të ndryshme qoftë nga ish-pjesëtarët po ashtu edhe nga shoqëria civile. Kjo rezultoi me demonstrata të dhunshme mirëpo që përfunduan pa pasoja të mëdha. Edhe procesi i ri-integrimit të pjesëtarëve të mbetur të TMK-së kalonte nëpër faza të ndryshme të trajnimit dhe programe për punësim në sektorin privat. Vlen të theksohet kontributi i madh i bashkësisë ndërkombëtare për ri-integrimin e këtyre pjesëtarëve e që deri në momentin e tanishëm u vlerësua si i suksesshëm.

Konkluzionet

Procesi i Çarmatimit, Demobilizimit dhe Rintegritimit (DDR) të ish pjesëtarëve të UÇK-së u vlerësua si i suksesshëm mirëpo tejet kompleks për rrethanat e Kosovës. Luftërat dërrmuese në hapësirat e ish-Jugosllavisë i bënë luftëtarët hezitues ndaj proceseve të vendosjes së paqes dhe rendit që rezultoi në vështirësi në pranimin e një realiteti të ri. Formimi i trashëgimtares së UÇK-së përmbushi sado pak ambiciet e ish-luftëtarëve që të mbeten ende 'nën uniformë' edhe pse në një organizatë civile me detyra specifike për reagim emergjent dhe mbrojtje civile.

Konsolidimi i TMK-së u vlerësua si i suksesshëm pavarësisht dobësive.²⁰ Rezultatet e këtij konsolidimi u vërejtën disa vite pas përfundimit të luftës e që konsistonte edhe në hapjen e dyerve për integrimin e minoriteteve dhe barazi gjinore në këtë institucion. Në përgjithësi, kontrolli demokratik mbeti një çështje brengosëse e që la gjurmë jo të mira në proceset e mëvonshme për ZHSS.

Arkitektura e re e sigurisë në Kosovë u përzgjedh kryesisht që të ndërtohet nga fillimi duke u bazuar më shumë në konceptin e ZHSS e pjesërisht në RSS. Kjo rezultoi sidomos në shpërbërjen e trashëgimtares së drejtpërdrejt të ish-luftëtarëve e që reagimet nuk munduan. Por, pavarësisht vështirësive dhe dilemave se a do të duhej të shkonte në këtë rrugë ky proces, rezultatet e DDR në Kosovë janë të pakontestueshme.

¹⁸ KCSS, Themelimi, Operacionalizimi dhe Funkcionimi Demokratik i FSK-së, f.9

¹⁹ Ibid, p. 22

²⁰ KCSS, Themelimi, Operacionalizimi dhe Funkcionimi Demokratik i FSK-së, f.3

Bibliografia

DCAF, *Democratic Control of Armed Forces*, 2008

<http://ëëë.kosovopolice.com>

<http://ëëë.unosek.org/unosek/en/statusproposal.html>

IOM, *Kosovo KPC*, Prishtinë, 2000

KCSS, *Context Analyzes of SSR in Kosovo*, Prishtinë, 2009

KCSS, *Themelimi, Operacionalizimi dhe Funksionimi Demokratik i FSK-së*, Prishtinë, 2008

KFOR, *Marrëveshja për demilitarizimin e UÇK-së*, Prishtinë, 1999

Kombet e Bashkuara, *Rezoluta 1244*, New York, 1999

NATO, *Marrëveshja Tekniko-Ushtarake e Kumanovës*, Kumanovë, 1999

UNDP, *ISSR*, Prishtinë, 2006

UNMIK, *Standards for Kosovo*, Neë York, 2003